

VENDIM
Nr.874, datë 18.6.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.723, DATË 19.11.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 “PËR STATUSIN
E INVALIDIT”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.723, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “...është 4 000 lekë...” zëvendësohen me “...është 6 000 (gjashtë mijë) lekë...”.

2. Efektet financiare, prej 4 800 000 (katër milionë e tetëqind mijë) lekësh, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontigjencës, miratuar në buxhetin e vitit 2008, grupi 25, titulli 10220, kapitulli 1, artikulli 606, zëri “Transferime korente të brendshme”, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha